



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 22.01.2020

Dokument parlamentar

**RAPORT**

**PËR DEKRETIN NR. 11414, DATË 11.01.2020, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR “KTHIMIN E LIGJIT NR. 92/2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008, “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

**- Hyrje**

Me dekretin nr. 11414, datë 11.01.2020, Presidenti i Republikës ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, është një propozim i Këshillit të Ministrave, i cili është shqyrtuar, në cilësinë e komisionit përgjegjës, nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2019.

Ligji 92/2019 është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të datës 18 dhjetor 2019.

**- DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 11414, datë 11.01.2020, të Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës 22 janar 2020.

Komisioni caktoi deputetin Arben Pëllumbi relator për dekretin.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të Institucionit të Presidentit të Republikës, Z. Bledar Dervishaj dhe Znj. Katrin Treska dhe përfaqësues të AKEP-it, Z. Bleron Dokle dhe Z. Jetmir Braho.

Arsyet e kthimit të ligjit nga Presidenti i Republikës u prezantuan në mënyrë të përmbledhur nga Këshilltari ligjor i Presidentit Z. Bledar Dervishaj.

Në dekretin e Tij, Presidenti i kërkon Kuvendit rishikimin e ligjit 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, në mënyrë që të rivlerësohet së bashku me ligjin nr. 91/2019, prej të cilit kushtëzohen ndryshimet, me qëllim përfshirjen e rregullave strikte për ngritjen e funksionimit e organeve administrative të pavarura, rivlerësimin e nivelit të masave administrative të parashikuara në analizë të realitetit ekonomik në të cilin janë ngritur e funksionojnë ofruesit e shërbimit të medias, rishikimit të procesit të vlerësimit dhe marrjes së masave administrative dhe ekzekutimit të tyre, si dhe rivlerësimin e efektit të drejtpërdrejtë që do të kenë në përditshmërinë e punës së ofruesve të shërbimit medietik elektronik nga parashikimet e reja ligjore.

Presidenti arsyeton se, në referim të qëndrimit të mbajtur në arsyetimin e Dekretit nr.11413, datë 11.01.2020, të Presidentit të Republikës, për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 91/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, bëhet e detyrueshme që ligjvënësi bashkarisht me shqyrtimin e ligjit nr. 91/2019, të rishqyrtojë edhe ligjin nr. 92/2019, pasi këto dy akte të reja ligjore janë pjesë e së njëjtës paketë të lidhura proceduralisht dhe materialisht me njëra- tjetrën.

Nëse Kuvendi i Shqipërisë, do të shqyrtojë e miratojë Dekretin nr. 11413, datë 11.01.2020, për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 91/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, kjo gjë ndikon dhe bën të detyrueshme rishikimin dhe reflektimin e qëndrimit edhe në ligjin nr. 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Në arsyetimin e kthimit të ligjit nr. 91/2019, Presidenti i Republikës ka parashtruar argumente mbi domosdoshmërinë e rishikimit nga Kuvendi të sanksioneve financiare, mënyrës së vendimmarrjes, organit që ka të drejtë të marrë vendimin, si dhe mbi mënyrën e ekzekutimit të këtyre sanksioneve, apo të masave të tjera ndëshkuese.

Shqetësimet për përhapjen e lajmeve të rreme, apo ndikimit negativ të dezinformimit, duhet të adresohen në mënyrë të tillë që çdo mjet ligjor mbrojtës ndaj këtyre fenomeneve të mos rrezikojë në asnjë rast, të vendosë në disbalancë, apo të krijojë rrezikun e keqpërdorimit të këtyre mjeteve ligjore për të cenuar të drejtën për informacion, lirinë e shprehjes dhe të medias apo dhe lirinë për veprimtari ekonomike, të drejta këto që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare.

Ndërsa delegimi me ligj një organi administrativ i kompetencave që Kushtetuta nuk ia lejon, mungesa e transparencës në procedurën e vendimmarrjes, dhe aplikimi i sanksioneve disproporcionale dhe pa

kaluar në shqyrtimin gjyqësor, nuk është në balancë mes interesit publik për mbrojtjen nga lajmet/informacionet e rreme, dhe të drejtës për informim, lirisë së shprehjes dhe zhvillimit të aktivitetit ekonomik në fushën e publikimeve elektronike.

Në këtë logjikë, edhe nenet 3 dhe 4 të ligjit nr. 92/2019, do të duhet të rivlerësohen në kuadër të rishqyrtimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të dispozitave respektive të ligjit nr. 91/2019, lidhur me masat ndaj ofruesve të shërbimeve medietike në rastet e shkeljes të dispozitave ligjore.

Lidhur me arsyetimin e Presidentit, përfaqësuesi i AKEP-it, Z. Bleron Dokle, u shpreh se, bazuar në përcaktimet e nenit 15 të ligjit 9918/2008, AKEP-i është i vetmi institucion rregullator përgjegjës për respektimin e kufizimeve për përmbajtjen e paligjshme që mund të publikojnë ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Pra, ndryshimet në ligjin 92/2019 nuk synojnë vendosjen e një rregullimi të ri ligjor, por synojnë përmirësimin e dispozitave ekzistuese të ligjit. Në këtë kuadër, ndryshimet në nenin 4 të ligjit, nuk synojnë vendosjen e masave ndaj medias që ofron shërbimin e publikimit elektronik, por ndaj ISP-ve, pra operatorëve të komunikimeve elektronike që ofrojnë shërbimin ndaj këtyre medieve. Pra, masa administrative do të vendoset mbi operatorët, ISP-të, që ofrojnë shërbimin e komunikimit elektronik dhe jo ndaj medias që ofron shërbimin e publikimit elektronik. Kjo masë është në përputhje të plotë me përmbajtjen e nenit 137 të ligjit, i cili i jep të drejtë AKEP-it të marrë masa ndaj çdo ISP-je që nuk respekton kufizimet për përmbajtjen e paligjshme. Por, sipas nenit 2 të ligjit, shqyrtimi apo vlerësimi i përmbajtjes së një faqe on-line, nuk mund të bëhet AKEP-i, por nga organet kompetente të përcaktuara me ligj. Bazuar në vendimin administrativ të organit të përcaktuar me ligj për vlerësimin e kontentit, AKEP-i ka të drejtën ligjore, sipas nenit 15 të ligjit ekzistues, për marrjen e masave ndaj ISP-ve.

Pra, ndryshimet e miratuara me ligjin 92/2019 synojnë përmirësimin e dispozitave ekzistuese në ligjin 9918/2008, dhe janë në përputhje me frymën e procedurës që ndiqet aktualisht nga AKEP-i.

Relatori u shpreh se, konstaton se në Dekretin e Tij, Presidenti nuk ka parashtruar asnjë argument të qenësishëm lidhur me ndonjë problematikë kushtetuese apo ligjore, e cila do të përbënte shkak për kthimin e ligjit për rishqyrtim në Kuvend, por arsyetimin e Tij e lidh vetëm me arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit 91/2019. Për këtë arsye, relatori propozoi rrëzimin e Dekretit të Presidentit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, vendosi **rrëzimin e Dekretit** të Presidentit të Republikës, nr. 11414, datë 11.01.2020, “Për “kthimin e ligjit 92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar” dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

**RELATOR**

**KRYETAR**

**Arben PËLLUMBI**

**Niko PELESHI**